



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 29.10.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2017, PËR PROJEKTIN “PROMOVIMI I NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME PËRMES FONDIT TË GARANCISË SË KREDIVE RURALE””

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale””, në mbledhjen e datës 29 tetor 2018.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Marrëveshja për bashkëpunim financiar 2017 për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale” parashikon përdorimin e shumës së financimit me vlerë të përgjithshme prej 5 milionë euro.

Projektligji ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunim financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale”. Ky bashkëpunim do të ofrojë një kontribut shumë të rëndësishëm në promovimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nëpërmjet fondit të garancisë, duke garantuar kreditë tregtare të institucioneve mikrofinanciare, të cilat do t’u ofrojnë kredi kredimarrësve në segmentin bujqësor e rural të ekonomisë.

Objekt i projektit “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale” është të inkurajojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mbi një bazë të qëndrueshme, duke u dhënë mundësinë për të krijuar vende të reja pune, të rriten dhe të bëhen më konkurruese.

Marrëveshjeja ka interes si në aspektin ekonomik dhe në atë social, duke marrë në konsideratë nevojën për mbështetje financiare dhe shtysa të mëtejshme në fushën e promovimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

Kushtet me të cilat vihet në dispozicion marrëveshja, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të lidhen ndërmjet KfW-së dhe të marrësve të shumës së financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

KfW-ja përjashtohet nga të gjitha tatimet dhe taksat direkte, që lindin në Republikën e Shqipërisë, në kontekstin e lidhjes dhe zbatimit të kontratave të këtij projekti.

Premtimi i shumës prej 5 milionë eurosh do të zhvlerësohet nëse kontratat përkatëse të financimit nuk lidhen deri në 31 dhjetor të vitit 2018.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj marrëveshjeje janë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Fondi Rural i Garancisë së Kredive

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare. Deputetët e opozitës nuk morën pjesë në mbledhje.

Besnik BARAJ

Eduard SHALSI

Relator

Kryetar